



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.703/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, rr. “Arbënor dhe Astrit Dehari”, kundër debitorit Subjekti Ekonomik “A...”, sh.p.k, me seli në fshatin ..., Komuna e Fushë Kosovës, njësia në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1164/21 të datës 06.08.2021, Zyra Përmbartimore VAIS Law, Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, me seli në Magjistralen Prishtinë - Shkup, jashtë seancës me datën 28.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Subjekti Ekonomik “A...”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1164/21 të datës 06.08.2021, i lejuar nga Zyra Përmbartimore VAIS Law, Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.1164/21 të datës 06.08.2021, i lejuar nga Zyra Përmbartimore VAIS Law, Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

A r s y e t i m

Kreditori, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit Subjekti Ekonomik “A...”, sh.p.k, me seli në fshatin ..., Komuna e Fushë Kosovës, njësia në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartimor – Aktvendimi Nr.8380 të datës 06.11.2020, i formës së prerë prej datës 02.08.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 02.08.2021,

dhe Vendimit Nr.8733 të datës 24.11.2020, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës t'ia paguaj shumën prej 1,000.00€ (një mijë euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirollogarinë Nr.1000-4000-7000-2411 të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Zyra Përmbartimore VAIS Law, Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut, me datë 06.08.2021, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.1164/21, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor, Aktvendimit të Inspektoratit të Tregut Nr.8380, të datës 06.11.2020 dhe Vendimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut Nr.8733, të datës 24.11.2020, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t'ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumën prej 1,000.00 € (një mijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbartuesit privat, si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori Subjekti Ekonomik "A...", sh.p.k., brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se propozimi për përmbartim është i kundërligjshëm, urdhri për përmbartim është lëshuar në kundërshtim me nenin 24 par.3 të LPP-së, Aktvendimet që kërkohet të përmbartohen janë në kundërshtim me rregullat e procedurës administrative, duke shtuar se Inspektorari i Tregut vendimin e ka marrë pas kalimit të afatit ligjor prej 8 ditësh. Tutje ka shtuar se Aktvendimet të cilat kërkohen të përmbartohen janë bërë të plotfuqishme në kundërshtim me nenin 128 par.1 të LPA-së, sipas të cilit ankesa e pezullon zbatimin e aktit administrativ, me vendim të kreditorit është dhënë e drejta për të paraqitur padi dhe debitori ka paraqitur padi për hapjen e konfliktit administrativ, mirëpo kreditori i ka bërë vendimet e plotfuqishme pa përfunduar kjo procedurë. Ka theksuar se aktvendimet në bazë të të cilave është marrë urdhri përmbartues nuk kanë titull ekzekutiv dhe tipare të përmbartueshmërisë siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së dhe nuk janë të formës së prerë. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet dhe urdhri përmbartimor të shfuqizohet për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrit.

Kreditori me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit për faktin se Aktvendimi i nxjerrë nga Inspektorati i Tregut, nuk përbën asnjë shkelje procedurale ngase me procesverbalin nr.0000465 të datës 28.09.2020, është konstatuar se debitori nuk ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët e tregut dhe të njëjtit i është dhënë mundësia që brenda afatit prej 8 ditësh të dorëzoj dokumentet e kërkuara nga inspektorët e tregut. Debitori ka paraqitur kërkesë për shtyerjen e afatit për dorëzimin e dokumenteve mirëpo kërkesë është refuzuar nga kryeinspektori dhe dokumentet nuk janë dorëzuar edhe pas kalimit të afatit ligjor të dhënë në procesverbalin e inspektimit. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se vendimet janë bërë të plotfuqishme në kundërshtim më nenin 128 të LPA-së, për faktin se ndaj ankesës së debitorit është dhënë vendimi dhe ky është vendim definitiv në procedurën administrative ndaj të cilit nuk është e lejuar ankesa dhe se vendimet kanë fuqinë e dokumentit përmbaresh ngase kanë vulën e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe të lejohet zhvillimi i procedurës përmbaresh.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaresh, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbaresh ka lejuar përmbareshin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbaresh e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareshin vetëm në bazë të dokumentit përmbaresh (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbaresh, përkatësisht Aktvendimi Nr.8380 të datës 06.11.2020, në bazë të së cilit përmbareshi privat ka lejuar përmbareshin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbaresh sipas të cilit mund të caktohet përmbareshi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr.8380 të datës 06.11.2020, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin

27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.8380 i datës 06.11.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.8380 i datës 06.11.2020, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 02.08.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 02.08.2021.

Gjykata po ashtu i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative mirëpo gjeti se Aktvendimi Nr.8380 i datës 06.11.2020 përbën dokument përbarimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“ Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përbarimin.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe

përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.703/22, datë 28.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.